



## Udhëzues për prindër për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve në internet



Дирекција за  
заштита на  
личните податоци

МЕТАМОРФОЗИС   
Фондација за интернет и општество

Shkup, qershor 2015

Udhëzuesi për prindër është përpiluar në kornizat e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Metamorfozis - Fondacioni për internet dhe shoqëri, si dhe shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit, si pjesë e projektit ORË PËR PRIVATËSINË.

Udhëzuesin e përpiluan:

- Mr. Liljana Pecova Ilieska, Drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe
- Mr. Tamara Resavska, Metamorfozis, Fondacioni për internet dhe shoqëri



Дирекција за  
заштита на  
личните податоци

Kontakti:

Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale

bul. „Goce Dellçev“ nr. 18, 1000 Shkup, Maqedoni,

Tel: ++389 (0)2 3230 635

Faks: ++389 (0)2 3230 635

email: [info@privacy.mk](mailto:info@privacy.mk)

web: [www.privacy.mk](http://www.privacy.mk)



Фондација за интернет и општество

Kontakti:

Metamorfozis, Fondacioni për internet dhe shoqëri

Rr. „Apostoll Gusllarot“ 40, Shkup, Maqedoni

Tel: ++ 389 (0)2 3109 325

email: [info@metamorphosis.org.mk](mailto:info@metamorphosis.org.mk)

web: [www.metamorphosis.org.mk](http://www.metamorphosis.org.mk)

## **Hyrje**

Disa punë ndryshojnë gjatë viteve, por disa punë mbesin të njëjta. Fëmijët e kanë të njëjtën nevojë për komunikim, nevojë të socializohen, të argëtohen, por edhe krahas kësaj më shumë se e nevojshme është të mbrohet privatësia e tyre duke parandaluar keqpërdorimin e të dhënave personale.

Ky udhëzues nuk ka për qëllim të Ju shqetësojë Juve, prindër e të krijojë frikë për botën e re të teknologjisë të cilën e shfrytëzon fëmija Juaj, por thjeshtë të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes për atë se si funksionojnë teknologjitë e reja, si mundet që bashkërisht të hulumtoni nëpër “detin e informacioneve”, si ta mbron fëmijën Tuaj nga qasja në përmbajtje dhe komunikime të papërshtatshme, si dhe cilat janë mekanizmat për paraqitje të rasteve në qoftë se Ju ose fëmija Juaj ballafaqohet me keqpërdorim të të dhënave personale nëpër rrjetet sociale.

Fokusi i këtij udhëzuesi është vendosur në internetin, rrjetet sociale, por gjithashtu janë paraqitur edhe forma tjera të komunikimit dhe vende kyçe ku është i mundshëm keqpërdorimi i të dhënave personale dhe shkelja e privatësisë.

Duke treguar interesim për teknologjitë të cilat i shfrytëzon fëmija Juaj, Ju mundeni të mësoni bashkë me atë dhe të dini se çka bën ai/ajo kur “rin” në internet.

*Nga autorët*

## **Për udhëzuesin**

Ky udhëzues u paraqit si nevojë pas shqyrtimit të analizave që i bëri Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale në vitin 2014, si dhe hulumtimit që u bë në kuadër të projektit ORË NGA PRIVATËSIA në vitin 2015, me ç'rast u konstatuan këto rezultate:

- Më se 64% e prindërve mendojnë se fëmijët e tyre nuk janë të njoftuar me politikat e privatësisë në rrjetat sociale të cilat i vizitojnë,
- Rrjetat sociale më së shumti i frikësojnë prindërit, kështu që 68% e tyre mendojnë se janë rreziku më i madh;
- 60% e prindërve mendojnë se rolin më të rëndësishëm në edukim e kanë vetë ata si prindër

Gjithë kjo për ne ishte tregues se është më se e nevojshme t'i qasemi përpilimit të një Udhëzuesi të këtillë ku do të trajtohen temat për mbrojtjen e privatësisë, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe siguria e fëmijëve në internet dhe të gjitha sfidat e mundshme që i sjell me vete përdorimi i internetit. Jemi të bindur se në këtë mënyrë do ta afrojmë (sjellim) informatën deri te secili prindër dhe do të veprojmë në mënyrë preventive në ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë shfrytëzimit të rrjetave sociale. Gjithashtu, shpresojmë .se do t'ju shërbejë si udhëzues me këshilla të dobishme, duke i promovuar mekanizmat për paraqitje të cilat i kanë në disponim qytetarët.

Dimitar Gjeorgjievski,  
Drejtor, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale

Me rritjen e përdorimit të përditshëm të internetit dhe rrjetave sociale, prindërit ballafaqohen me një sfidë të re, e ajo është se si t'i mbrojnë fëmijët e tyre nga rreziqet të cilat në vete i mban interneti, si dhe t'i mësojnë që t'i përdorin ato në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme. Fondacioni Metamorfozis me punën e saj shumëvjeçare në këtë lëmi ka krijuar më tepër resurse të cilat i dedikohen edukimit të fëmijëve dhe prindërve për atë se si ta mbrojnë privatësinë e tyre dhe si ta përdorin në mënyrë të sigurt internetin. Ky udhëzues paraqet vazhdimin e atyre përpjekjeve dhe kontribuon në rritjen e vetëdijes tek prindërit për mbrojtjen e privatësisë. Qëllimi jonë nuk është t'i frikësojmë prindërit nga interneti dhe teknologjitë e reja, por përkundrazi, t'u mundësojmë që maksimalisht të përfitojnë nga interneti me atë që do të jenë në rrjedha me ndryshimet në botën digjitale, do të pasurohen me shkathtësi të reja, do t'i nxisin të mendojnë për çështjet lidhur me rreziqet dhe përparësitë e përdorimit të internetit, e njëkohësisht do t'u ndihmojmë të merren me sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë edukimit të fëmijëve për përdorim të internetit në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.

Bardhyl Jashari,  
Drejtor, Fondacioni Metamorfozis

## Përmbajtja

Kapitulli 1 .....	1
Çka është interneti? .....	1
Fjalor i shprehjeve në lidhje me internetin.....	2
Politikat për privatësi në rrjetat sociale .....	4
Kapitulli 2 .....	6
Çka është privatësia? Cilat janë të dhënat personale që e zbulojnë identitetin tonë? .....	6
Cilat janë rreziqet që i kanosin fëmijët në Internet? .....	7
Vjedhja e identitetit .....	7
Çka është fishing? .....	8
Gjuha e urrejtjes .....	10
Çka është sajberdhuna? .....	11
Onlajn grabitqarët.....	12
Varshmëria nga video lojrat.....	13
Çka thonë profesorët? .....	15
Si mendojnë prindërit? .....	16
Kapitulli 3 .....	17
Mekanizmat për paraqitje .....	17
Kapitulli 4 .....	19
Softuerë të dobishëm për mbrojtje të privatësisë së fëmijëve tuaj .....	19
Këshilla për mbrotje të privatësisë së fëmijëve tuaj.....	23
Resurse të dobishme.....	25
Shtojca.....	26
Shtojca 1 – Akronimet që më shpesh përdoren nga tinejxherët .....	26

# Kapitulli 1

## Çka është interneti?

**Interneti** është bashkësi kompjuterësh nga e gjithë bota të lidhur ndërmjet veti me qëllim të shkëmbimit të informatave. Fjala Internet vjen nga kombinimi i fjalëve “**I**nternational” (ndërkombëtare) dhe “**n**etwork”(rrjetë).

„Interneti fillimisht ishte paramenduar si një bazë e madhe e të dhënave që përdorej për qëllime shkencore dhe arsimore. Nga kjo rrjedh se roli kryesor i Internetit ishte arkivimi dhe komunikimi. Ashtu siç rritej numri i kompjuterëve të lidhur në Internet, rritej edhe numri i organizatave të cilat ofronin on-lajn informata dhe numri i vizitorëve të ueb faqeve (të cilët janë shfrytëzues potencial të prodhimeve apo shërbimeve).

Sot, Interneti mundëson më tepër shërbime:

### 1. **Informata (informacione),** nëpërmjet:

- World Wide Web (rrjetës gjithëbotërore - WWW) -- e cila krahasohet me konsultimin e një biblioteke të madhe digjitale
- Grupe gazetash – e krahasueshme me revista të dedikuara temave të ndryshme

### 2. **Komunikime,** nëpërmjet:

- Pranimi dhe dërgimi të letrave:
- Program për bisedë nëpërmjet lidhjes së drejtpërdrejtë i ngjashëm me lidhjen telefonike i cili mundëson bisedë në kohë reale
- Posta elektronike (e-mail): me lidhje indirekte, ngjashëm me postë
- Grupe diskutimi: me shkëmbimin e porosive në kuadër të një grupi (grupe diskutimi, grupe gazetash (lajmesh))
- Konferenca: me lidhje direkte të njëkohshme ndërmjet më tepër shfrytëzuesve
- Bartja e të dhënave:
  - FTP shërbimi (protokol për bartje të datotekave), i cili mundëson bartje të shpejtë të datotekave
  - Bashkëngjitja e datotekave në porositë që dërgohen me postë elektronike
  - Shkarkimi nga Interneti nëpërmjet WWW
  - Peer to peer, që mundëson kopjimin e datotekave nga kompjuterë tjerë falas ose me një çmim të caktuar.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> „Manual për teknologjitë e informatikës dhe komunikimit“ – 2006, USAID – projekt për qeveri elektronike, linku: <http://aa.mk/WBStorage/Files/Priracnik%20IKT%20Mak.pdf>

## Fjalor i shprehjeve në lidhje me internetin

### 1. Çka është rrjetë sociale?

a. Onlajn bashkësi e njerëzve me interesa të përbashkëta të cilët shfrytëzojnë ueb faqe ose ndonjë teknologji tjetër me qëllim të komunikimit të ndërsjellë dhe shpërndarjen e informatave, resurseve, etj.

b. Ueb faqe ose onlajn shërbim të cilët e mundësojnë komunikimin.

2. Kur fëmija Juaj është “**onlajn**” do të thotë se ai lidhet në internet. Edhe pse WWW është vetëm një pjesë e internetit, prapë se prapë, nocionet siç janë **Web** (Ueb), **Internet** dhe **Net** shpesh përdoren që të tregojnë të njëjtën – lidhjen në rrjetin global të informacioneve dhe komunikimit.

3. Nocioni **Ueb (Web)** paraqet edhe bashkësinë e më tepër **Ueb sajteve (Websites)** në internet. Përmban edhe informata për cilën do temë të mundshme ose lëmi të interesit. Ueb sajti është faqe e www e cila përmban informatë. Për shembull, ueb saji i Drejtorisë për mbrojtje të të dhënave personale është [www.dzlp.mk](http://www.dzlp.mk). Kjo është **ueb adresa** e këtij instituti.

4. **Rrjetëzim social** është shfrytëzimi i ueb sajteve ose onlajn teknologjive tjera me qëllim të komunikimit dhe shpërndarjes së informatave, etj.

Kohë më parë nga hulumtimet doli edhe lista e [Dhjetë faqeve më të popullarizuara për rrjetëzim social](#):





Google Plus+ 120,000,000 vizitorë në muaj



Tumblr 110,000,000 - vizitorë në muaj



Instagram 100,000,000 vizitorë në muaj



VK 80,000,000 vizitorë në muaj



Flickr 65,000,000 vizitorë në muaj



Vine 42,000,000 - vizitorë në muaj



Meetup 40,000,000 - vizitorë në muaj



Tagged 38,000,000 - vizitorë në muaj



Ask.fm 37,000,000 - vizitorë në muaj



MeetMe 15,500,000 - vizitorë në muaj





**ClassMates 15,000,000** - vizitorë në muaj

Komunikimet në rrjetat sociale më së shpeshti përmbajnë shkurtesa, të cilat u janë të njohura vetëm më të rinjve. Kështu që, në internet mund të gjendet edhe lista e akronimeve që më së shpeshti përdoren nga ana e tinejxherëve (këtu në Shtojcën 1.) të cilat janë posaçërisht të deshifruara për prindërit e hutuar.

## Politikat për privatësi në rrjetat sociale

Politikat për privatësi janë rregulla të cilat na informojnë të gjithë ne, si shfrytëzues të internetit, se në çfarë mënyre mbledhen të dhënat. Në qoftë se duam të dimë si të udhëheqim me informatat dhe si ta mbrojmë privatësinë tonë në internet, rregullat duhet të lexohen me vëmendje dhe të ndiqen vazhdimisht pasi që ata pësojnë ndryshime.

Për shembull, në shumicën e shërbimeve kërkohet që ju të hapni llogarinë tuaj shfrytëzuese në Google. Kur ju do ta bëni këtë, që të paralajmëroheni në profilin tuaj kërkohen të dhëna personale siç janë: emri, mbiemri, email, numri i telefonit ose kartelës kreditore për ruajtjen e profilit tuaj, e kështu me radhë. Nëse dëshironi tërësisht t'i shfrytëzoni mundësitë për shpërndarjen e përmbajtjeve të cilat ofrohen, prej jush kërkohet që të krijoni një profil publik në Google ose atë ekzistuesin ta bëni publik, e kjo përfshin shfaqje publike të emrit, mbiemrit dhe fotografisë tuaj.

Për më tepër, ueb sajtet mbledhin të dhëna me vetë shfrytëzimin e shërbimeve të tyre. Në të vërtetë, ata mbledhin të dhëna për pajisjen, p.sh. modelin e harduerit tuaj, versionin e sistemit operativ, informata për rrjetin celular, duke përfshirë edhe numrin tuaj të celularit.

Për shembull, kur ju i shfrytëzoni shërbimet e Google-it, të dhënat për lokacionin tuaj, IP adresa, Wi-Fi pikat e qasjes, etj. mund të mbledhen dhe të përpunohen. Gjithashtu, mund të mbledhen edhe të dhëna për identifikimin e ueb shfletuesit tuaj ose pajisjes tuaj me shfrytëzimin e biskotave (Cookies).

**Biskotat (cookies)** janë fajlla të vogël tekstual me të dhëna, të cilat mund të regjistrohen në hard diskun tuaj nga ndonjëra ueb faqe të cilën i keni vizituar dhe më shpesh përdoren për qëllime reklamuese, por, njëkohësisht e ndjekin ("gjuajnë") edhe lëvizjen tuaj (derisa surfoni) në ueb faqe.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> <http://www.google.com/policies/privacy/>

Gjithmonë, por gjithmonë! lexoni Politikat për privatësi të medimeve sociale, shërbimet të cilat i ofrojnë, pasi që aty është edhe ilaçi si të mbroheni në qoftë se është shkelur privatësia juaj apo e fëmijës tuaj.<sup>3</sup>



---

<sup>3</sup> <https://www.facebook.com/about/privacy/>

## Kapitulli 2

### Çka është privatësia? Cilat janë të dhënat personale që e zbulojnë identitetin tonë?

E drejta e mbrojtjes së të dhënave personale dhe e drejta e privatësisë janë të drejta të ndryshme njerëzore. Për shkak të rëndësisë së madhe të privatësisë së individit, në pjesën më të madhe të shteteve kjo e drejtë është e rregulluar me Kushtetutë si akt më i lartë konstituiv shtetëror, ashtu siç është rasti edhe me Republikën e Maqedonisë.

Në Kushtetutën tonë, në pjesën që i kushtohet Lirive dhe të drejtave qytetare dhe politike, janë përfshirë disa të drejta njerëzore të cilat janë komponentë të së drejtës për privatësi, sepse privatësia është një koncept më i gjerë, respektivisht sublimat i disa të drejtave individuale. Në këtë kuptim, është me rëndësi të përmenden të drejtat në vijim:

- Secilit qytetar i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës së tij personale dhe familjaredhe, si dhe e dinjitetit dhe reputacionit. (neni 25).
- Secilit qytetar i garantohet paprekshmëria e shtëpisë. E drejta e paprekshmërisë së shtëpisë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor kur është në pyetje zbulimi apo ndalimi i veprave penale ose shëndeti i njerëzve (neni 26).
- Garantohet liria dhe fshehtësia e letrave dhe e të gjitha formave tjera të komunikimit. Nga kjo e drejtë mundet të iket (shmanget) vetëm me vendim gjyqësor dhe me procedurë përkatëse ligjore (neni 17).

Ngritja e të drejtës për privatësi në rangun e një të drejte njerëzore të garantuar me kushtetutë tregon në rëndësinë e madhe të kësaj të drejte për individin, e cila me vete mbart disa të drejta/autorizime përkatëse dhe obligime/përgjegjësi edhe atë si për individin si mbartës i të drejtës, ashtu edhe për individë të tjerë, por edhe për shtetin dhe institucionet e tij. Këto janë tre nene në Kushtetutën e RM të cilat garantojnë mbrojtjen e privatësisë. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka të bëjë vetëm me të drejtat e qytetarit për mbrojtjen e të dhënave të tij personale.

Në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston ligj i veçantë i cili ka të bëjë me mbrojtjen e privatësisë, derisa në SHBA ka një ligj të veçantë për mbrojtjen e privatësisë së fëmijëve dhe ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave personale onlajn nga persona fizik dhe juridik nën jurisdikcionin amerikan për fëmijë nën moshën 13 vjeçare<sup>4</sup>. Kjo do të thotë se janë të definuara të dhënat të cilat operatori i ueb sajtit duhet t'i kyçë në politikën e privatësisë, kur dhe si të kërkohet pëlqim i prindit ose kujdestarit, si dhe cilat janë obligimet e operatorit me të cilat ai duhet ta mbrojë privatësinë e fëmijëve në internet, duke i përfshirë këtu edhe kufizimet për marketing për ata që janë nën moshën 13 vjeçare.

---

<sup>4</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Children%27s\\_Online\\_Privacy\\_Protection\\_Act](https://en.wikipedia.org/wiki/Children%27s_Online_Privacy_Protection_Act)

Të dhënat personale të cilat e zbulojnë identitetin tonë zakonisht janë:

- Emri dhe mbiemri
- Adresa e banimit
- Numri i amzës
- Gjinia, etj. respektivisht gjithë çka mund të sjellë deri te identifikimi dhe verifikimi i identitetit të një personi.

## Cilat janë rreziqet që i kanosin fëmijët në Internet?

Me zhvillimin e teknologjive të reja dhe mënyrën e komunikimit, më së shumti brengosemi që fëmijët mos hyjnë në kontakt onlajn me njerëz të gabuar, mos kenë qasje në përmbajtje të papërshtatshme ose materiale dhe mos të keqpërdoren në asnjë lloj mënyre.

Në vijim ju paraqesim rreziqet më të shpeshta për fëmijët e juaj në internet dhe keqpërdorimet e të dhënave personale me të cilat mund të ballafaqoheni, si dhe rekomandimet si të merreni me to.

### Vjedhja e identitetit



Vjedhja e identitetit është formë e vjedhjes së të dhënave për identifikim personal të një personi tjetër, me ç'rast vjedhësi paraqitet se është dikush tjetër, duke marrë identitetin e një personi tjetër dhe atë më shpesh me qëllim që të qaset te resurset ose të përfitojë beneficione tjera në emër të atij personi.

Vjedhja e identitetit më shpesh përdoret si mënyrë për kryerje të aktiviteteve kriminale dhe përfshin përdorim të paautorizuar të të dhënave Tuaja personale, më shpesh të dhëna bankare që përdoren për t'u grabitur ose për të bërë krim në emrin Tuaj. Vjedhja e identitetit mund të kryhet onlajn, fizikisht duke përdorur dokumente të printuara, ose me kombinim të të dyjave.

**Vjedhja e identitetit të fëmijëve** ndodh kur të dhëna personale dhe numri i amë i një të mituri përdoren nga dikush tjetër për qëllime personale, më shpesh qëllime financiare. Vjedhësi mund të jetë anëtar i familjes, shokë ose ndonjë i huaj.

### Disa nga mënyrat e vjedhjes së identitetit janë:

- Vjedhja e të dhënave personale nga kompjuterët duke përdorur [softuer qëllimkeq](#) (malware), veçanërisht [kali trojan](#) (trojan horse) ose forma tjera të [softuerit spiun](#) (spyware)
- Të qëlluarit e shifrave të numrit amë duke shfrytëzuar informacione të gjetura në rrjetat sociale siç është Facebook (për shembull; data të lindjes të bëra publike në Facebook)

- Fotografi të publikuara të cilat mund lehtë të merren prej ueb faqeve.
- Miqësimi me persona të panjohur nëpër rrjetat sociale dhe shfrytëzimi i besimit të tyre që të arrihet deri te të dhënat personale.

#### **Prandaj, këshilloni fëmijët tuaj që:**

- Të mos shkëmbejnë të dhëna personale me shokët/shoqet e tyre, apo njerëz tjerë.
- Gjithmonë të kenë të instaluar program antivirus dhe program që mbron nga spiunimet e pajisjes me të cilën qasen në internet.
- Asnjëherë të mos zbulojnë të dhëna personale duke u përgjigjur ndaj ndonjë emaili, letre ose thirrjeve telefonike nëse nuk janë të sigurt se kërkesa për këto të dhëna është nga një burim i sigurt.
- Të ju informojnë menjëherë nëse tek ato arrin ndonjë porosi elektronike e dyshimtë e cila kërkon ndonjë lloj të të dhënave personale

### Çka është fishing?

Fishingu është formë e mashtrimit i cili përfshin përmbledhjen e aktiviteteve të dërguesve të paautorizuar, të cilët dërgojnë porosi të rrejshme nga email adresa dhe ueb faqe të rrejshme të organizatave financiare, duke u përpjekur që prej shfrytëzuesve të marrin të dhëna personale të besueshme siç janë, Numri amzë i qytetarit, emri i shfrytëzuesit, PIN kodi, etj. Për fat të keq ka një numër të madh të shfrytëzuesve të cilët nuk janë të njoftuar me këtë lloj mashtrimi. Menjëherë, sapo të marrin të dhënat e besueshme, dërguesit keqbërës ose i shfrytëzojnë vetë ato të dhëna ose i shesin. Në porosinë që i dërgojnë, më shpesh thirren në ueb faqe të rrejshme të cilat për nga pamja plotësisht janë të njëjta me ueb faqet legjitime të kompanive (ndërmarrjeve).

#### **Format më të shpeshta të fishingut janë:**

- Paralajmërim/vërejtje të rrejshme nga banka ose nga një organizatë tjetër financiare ku nga shfrytëzuesi kërkohet që t'i japë të dhënat personale që të mos vijë deri te ndërprerja/mbyllja e llogarisë.
- Mashtrime nga ueb faqe për licitacione, në të cilat shfrytëzuesi bindet që të paguajë një shumë të caktuar parash që të blejë një prodhim të caktuar, në ndërkohë ai duke menduar se blen ndonjë prodhim bën pagesë te ndonjë llogari të rrejshme.
- Porosi të rrejshme nga administratori ku kërkohen nga shfrytëzuesi të dhëna, siç është fjalëkalimi.
- Lajmërim të ndryshme që të mbledhen të holla për qëllime të rrejshme bamirësie.
- Porosi me të cilat mashtrohet shfrytëzuesi që të paguajë një shumë parash në një llogari të rrejshme (p.sh. porosi me zbritje drastike të çmimit të ndonjë prodhimi të caktuar i cili mund të blihet vetëm në internet).
- Porosi të cilat Ju informojnë se keni fituar në lotari dhe u nevojiten të dhënat Tuaja personale që të mund të merrni shpërblimin.



### **Si mund të njihni një fishing porosi?**

Mashtruesit më shpesh kopjojnë pamjen vizuale të ueb faqeve të vërteta të bankave apo kompanive tjera. Në kohë të fundit porositë e rrejshme janë plotësisht identike me origjinalet, megjithatë ekzistojnë disa detaje të cilat e zbulojnë mashtrimin:

- Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore;
- Kërkohen të dhëna personale;
- Kërkohet të instalohet program i cili do të gjejë dhe rregullojë lëshimin në siguri;
- Linqe të rrejshme dhe porosi
- Mospërdorimi i SSL dhe certifikatit digjital;
- Përmbajtja e porosisë është HTML formular
- Premtime joreale;
- Gabime në temën e porosisë;
- Kërkohet përgjigje urgjente

## Gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes është gjuhë e anshme, armiqësore, qëllimkeqe e drejtuar kah një njeri ose grup njerëzish për shkak të disa karakteristikave të cilat i kanë ata ose thuhet se i kanë. Në kuptimin më të gjerë, gjuha e urrejtjes përdoret për të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtje të bazuar në jotolerancë, mbi çfarëdo baze të diskriminimit.

Gjuha e urrejtjes është keqpërdorim i lirisë së të shprehurit që përkon me shkeljen e të drejtave të të tjerëve.

Në kuptimin më të gjerë, me **gjuhën e urrejtjes “onlajn”** (“sajber-urrejtje”) nënkuptohet çdo lloj përdorimi i teknologjisë së komunikimeve elektronike për përhapjen e përmbytjeve antisemite, raciste, ksenofobe, diskriminuese, ekstremiste ose terroriste.

Gjuha e urrejtjes “onlajn” është më e gjerë se sa shprehja e gjuhës së urrejtjes në internet, për shkak se nuk i përfshin vetëm përmbytjet në internet (uebfaqet, rrjetet sociale, përmbytjet e gjeneruara nga shfrytëzuesit, blogjet, lojërat onlajn, e-maillet etj.), por edhe përmbytjet e telefonave celularë.

### Si duket gjuha e urrejtjes?

Nën prizmin e humorit, shfrytëzuesit francez të twitterit publikuan porosi urrejtjeje ndaj Hebrenjve duke i grupuar ato me hashtag „#hebreimirë“, „#hebreivdekur“ („#unbonjuif“, „#unjuifmort“).

Shoqatat franceze paditën kompaninë Twitter për shkak të nxitjes publike të diskriminimit, urrejtjes ose dhunës. Pas paditjes, kompania ishte e obliguar që t'i japë të dhënat me të cilat do të identifikoheshin internet shfrytëzuesit të cilët kanë qenë autorë të twiteve.

### Çka të bëni nëse fëmija juaj është viktimë e gjuhës së urrejtjes onlajn?

- Paraqitni veprën penale në polici ose në Prokurorinë publike. Sipas Ligjit penal të RM përhapja e urrejtjes është veprë penale për të cilën pason dënimi prej 1 deri 10 vjet burgim. Në RM paraqitja mund të bëhet në mënyrë anonime në stacionin më të afërt policor, nëpërmjet telefonit 192 ose te Departamenti për kriminel kompjuterik në emailin: [cybercrime@moi.gov.mk](mailto:cybercrime@moi.gov.mk).
- Në rrjetat sociale Facebook dhe Twitter:
- Përgjigjuni posteve ose twiteve të cilët përhapin urrejtje duke potencuar autorin se çka në të vërtetë ai bën, si dhe përdorimi i hashtagut #непрази ose #mosurrej.
- Shfrytëzoni mekanizmat për paraqitje “me buton” të ofruar nga mediumi nga i cili komunikohet porosia

Mos harroni: Gjuha e urrejtjes më shpesh zgjerohet kur askush nuk i kundërvihet. Sepse më së shpeshti. Për disa prej mundësive të paraqitjes së gjuhës së urrejtjes mund të lexoni më tepër në pjesën “udhëzime” në ueb sajtin “Mos urrej” ([nemrazi.mk/category/upatstva](http://nemrazi.mk/category/upatstva)).

## Çka është sajberdhuna?

Shoqërimi social dhe mundësitë e shumta që i ofron interneti janë karakteristikat e shekullit 21. Jeta e fëmijëve zhvillohet njëkohësisht në disa vende, siç janë korridoret e shkollës, shtëpitë e miqve të tyre, por edhe në internet.

Shumica e fëmijëve dhe tinxherëve pjesën më të madhe të kohës e kalojnë me celularin e tyre ose në kompjuter, duke biseduar me miqtë e tyre, duke postuar fotografi, video dhe muzikë në rrjetat e ndryshme sociale, të cilat u mundësojnë shoqërim dhe zbavitje. Ndoshta kanë onlajn shokë të cilët asnjëherë nuk i kanë takuar në të vërtetë, me të cilët luajnë loja dhe këmbejnë porosi.

Dhuna onlajn, e cila quhet sajberdhunë, ndodh kur fëmijët dhe tinxherët, duke shfrytëzuar internetin, celularët ose pajisje tjera teknologjike, shkruajnë informata fyese në formë të tekstit, fotografive ose të përmbajtjeve të llojeve tjera, me qëllim që të lëndojnë dhe të turpërojnë persona të tjerë.

### Si mund të duket sajberdhuna?

- Shqetësim – dërgimi i vazhdueshëm i porosive fyese, shqetësuese dhe të ashpra si dhe materialeve pornografike
- Imitimi – depërtimi nëpër llogari shfrytëzuese të huaja dhe dërgim i porosive të rrejshme dhe të turpshme në emër të dikujt tjetër
- Nënçmimi – shkruarja e thashethemeve ose deklaratave tjera jo të sakta të cilat mund ta dëmtojnë viktimën, si dhe fotografi me përmbajtje nënçmuese dhe të turpshme dhe dërgimi ose publikimi i tyre në internet
- Mashtrime dhe zbulime publike – shpërndarja e informatave personale të huaja duke mashtruar dikë që t'ju besojë e t'i ndajë fshehtësitë me atë me qëllim t'i dërgojë dikujt tjetër
- Shprehje vulgare – dërgimi i porosive me përmbajtje vulgare
- Sajberkanosja – të frikësuarit konstant të viktimës për sigurinë e tij

### Çka nëse fëmija juaj është viktimë e sajberdhunës?

- Këshilloni fëmijët tuaj që ti bllokojnë komunikimet me sajberdhunuesit, të mos i hapin e as t'u përgjigjen emailave kur e dinë se janë nga sajberdhunuesi.
- Kërkoni nga ato që t'ua tregojnë porositë nëse ballafaqohen me ndonjë problem dhe bashkërisht bisedoni për përmbajtjen e tyre.
- Ruani ose i printoni të gjitha porositë nga dhunuesit si dëshmi, të cilat pastaj mund t'ua tregoni internet provajderëve të shërbimeve, madje edhe policisë, të cilët më pas do të mund të merren me dhunuesin.
- Nëse janë keqpërdorur të dhënat personale të fëmijës tuaj në internet, mund ta paraqitni rastin në Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale ([www.dzlp.mk](http://www.dzlp.mk)).
- Për raste të rënda të sajberdhunës, të cilat përfshijnë edhe dhunë fizike, mund të drejtoheni në polici.



- Paraqitni keqpërdorimet në ueb sajtet dhe rrjetat sociale të cilat kanë opsione përkatëse për të bllokuar ndonjë person ose porosi (Report ose Block) ose paraqitje të përmbajtjeve të papërshtatshme, ose t'i drejtoheni drejtpërdrejt administratorit.
- Më me rëndësi është që të flisni me fëmijët tuaj për atë se çka bëjnë ato në internet.

## Onlajn grabitqarët

Interneti është shumë më anonim se sa bota reale. Njerëzit mund ta fshehin identitetin e tyre, madje edhe të bëhen kinse janë dikush tjetër. Kjo mund të paraqesë një rrezik të vërtetë për fëmijët dhe tinejxherët të cilët janë onlajn. Onlajn grabitqarët mund të përpiqen t'i mashtrojnë fëmijët dhe tinejxherët në biseda seksuale, madje të kërkojnë edhe takime personale. Grabitqarët ndonjëherë dërgojnë porosi me përmbajtje të papërshtatshme ose të kërkojnë nga fëmijët që t'u dërgojnë fotografi. Prandaj, është me rëndësi t'i mësoni fëmijët tuaj që gjithmonë të kenë kujdes kur janë onlajn.

Tinejxherët janë në përgjithësi në rrezik më të madh nga onlajn grabitqarët, pasi që janë kureshtarë dhe duan të jenë të pranueshëm, ata mund të bisedojnë vullnetarisht me grabitqarë, madje edhe nëse e dinë se është e rrezikshme. Ndonjëherë ata mund të besojnë se janë të dashuruar tek dikush onlajn, duke i rritur kështu gjasat që të pajtohen të dalin në takim ballë për ballë me dikë.

### Si të zbuloni se fëmija juaj ndoshta është viktimë e onlajn grabitqarëve?

- Derisa fëmija juaj është i prirë nga një grabitqar, ai mund të kalojë më tepër kohë në dhomat për çet (bisedë).
- Fëmija juaj merr telefonata nga njerëz që ju nuk i njihni ose kërkon numra të cilat ju nuk i njihni.
- Fëmija juaj fiton dhurata me postë nga qytete tjera ose prej jashtë shtetit prej njerëzve që ju nuk i njihni.

!Gorbitqarët shpesh herë u dërgojnë letra ose dhurata viktimave të tyre potenciale.

### Çka t'i këshilloni fëmijët tuaj:

- T'ju ikin emrave sugjestiv ose fotografive të cilat mund të tërheqin vëmendjen e grabitqarëve. P.sh. Sexygirl15, hotboy2001.
- Nëse dikush i lëvdon ose u jep komplimente onlajn duhet të jenë të kujdesshëm. Predatorët mund të përdorin këtë lloj fjalori vetëm e vetëm që të përpiqen të fillojnë lidhje me tinejxherë. Kjo s'do të thotë se duhet të dyshojnë tek të gjithë, por duhet të jenë të kujdesshëm.
- Të mos bisedojnë me dikë që dëshiron të bisedojë për gjëra shumë personale. Nëse dikush dëshiron të bisedojë për gjëra seksuale apo tepër personale, atëherë ata duhet ta ndërprejnë bisedën.
- Të kenë ndërmend se njerëzit nuk janë çdo herë ashtu siç tregohen. Grabitqarët mund të bëhen kinse janë fëmijë apo tinejxherë me qëllim që të bisedojnë me fëmijë onlajn, mund të përdorin fotografi të rrejshme ose të shtojnë informata tjera në profilin e tyre që do t'i bënte ata më bindës.

- Asnjëherë të mos lënë takim me dikë që e kanë njoftuar onlajn. Grabitqarët mund të përpiqen të lënë takim me fëmijë apo tinxherë. Edhe nëse personi duket i sjellshëm dhe aspak i rrezikshëm, kjo gjë mund të jetë tepër e rrezikshme.
- Menjëherë t'i tregojnë prindit ose ndonjë të rrituri të cilit i besojnë nëse hasin në ndonjë problem. Nëse dikush i bën atë të ndihen në siklet, duhet menjëherë t'i tregojnë prindit ose ndonjë të rrituri të cilit i besojnë. Njëkohësisht duhet t'i ruajnë email porositë dhe komunikimet tjera që i kanë bërë me grabitqarin, sepse mund të nevojiten si dëshmi.

#### **Mos harroni:**

- Bisedoni me fëmijët tuaj për onlajn grabitqarët dhe rreziqet që sjell interneti.
- Vendoseni kompjuterin tuaj në një hapësirë të përbashkët ku ju do të keni mundësi ta mbikëqyrni (vrottoni) fëmijën tuaj derisa është në internet.
- Caktoni kufizimin kohor për përdorimin e kompjuterit.

#### **Varshmëria nga video lojërat**

Varshmëria nga video lojërat paraqet përdorim të tepruar të lojërave kompjuterike dhe video lojërave të cilat kanë ndikim në jetën e individit.

Disa prej shenjave emocionale të varshmërisë nga video lojërat janë ndjenja e shqetësimit dhe sikletit kur nuk luajnë, preokupim me aktivitetet e mëparshme online ose pritja me padurim e sesionit të ardhshëm, të gënjerit ndaj shokëve ose anëtarëve të familjes për kohën e kaluar në internet, izolim nga të tjerët me qëllim që sa më tepër kohë të kalohet duke luajtur.

#### **Shenjat sipas të cilave ju mund të njihni varshmërinë nga video lojërat:**

- Preokupimi – Fëmija kalon shumë kohë duke menduar për lojërat, madje edhe kur nuk luan ai planifikon çka do të luajë në vijim.
- Tërheqja (izolimi) – Ndjenja e shqetësimit, iritimit, disponimi jo i mirë, nervoza, ankthi ose dëshpërimi kur fëmija do të tentojë ta zvogëlojë kohën që e kalon duke luajtur ose të ndalojë së luajturi, ose kur nuk mund të luajë fare.
- Toleranca – Fëmija ndjen se duhet të luajë sa më shumë e më shumë, të luajë lojëra më ekscituese ose të përdorë pajisje më të fuqishme që ta arrijë nivelin e ekscitimit si më parë.
- Zvogëlimi/ndalimi – Fëmija ndjen se duhet të luajë më pak, por nuk mund ta shkurtojë kohën të cilën e kalon duke luajtur loja.
- Të hequrit dorë nga aktivitetet tjera – Fëmija e humb interesimin ose sa më pak merr pjesë në aktivitete tjera rekreative (hobi të ndryshme, takime me shokë) për shkak të lojërave.
- Vazhdon edhe krahas problemeve – Fëmija vazhdon të luajë edhe pse është i vetëdijshëm për pasojat negative, siç janë mungesa e gjumit, vonesa në shkollë, harxhimi i parave, qortimi me të tjerë ose neglizhenca ndaj detyrave të rëndësishme.
- Mashtrimi/ fshehja – Fëmija e gënjen familjen, shokët dhe të tjerët për kohën të cilën e kalon në lojë.

### **Çfarë të bëni nëse fëmija juaj kalon shumë kohë duke luajtur loja?**

- Kufizimi i kohës që fëmija e kalon para kompjuterit.
- Bisedoni me fëmijën tuaj për anët negative të luajtjes së tepruar dhe mungesës së socializmit.
- Shkoni në kinema dhe shihni një film hit, nxiteni atë që të dalë dhe të argëtohet me shokë.
- Ia bëni me dije se ka jetë edhe jashtë video lojërave – mos harro ta jetosh..

## Çka thonë profesorët?

### **Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet një nxënës i cili ka profil në rrjetat sociale?**

Përgjigjet i gjetëm nga disa koordinatorë të projektit [ORË PËR PRIVATËSI](#):

*Mr. Nikolina Ivanovska, profesoreshë e psikologjisë në shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit "Nikolla Karev"*

„Të poseduarit e një profili në rrjetat sociale nga një nxënës i mitur ka përparësitë dhe mangësitë e tij. Paralelisht me ato përparësi të njohura në drejtim të socializmit, qasjes së shpejtë deri te risitë dhe informacionet, shpesh në nivel të pavetëdijes nuk përfillen edhe disa mangësi që kanë ndikim të madh në zhvillimin e personalitetit të të miturit. Jo rrallë hasim në raste të cilat vlerësimi i vetes bëhet në bazë numrit të lajkave për një fotografi, e kjo drejtpërdrejtë ndikon në segmente më serioze të zhvillimit të personalitetit për shkak të dallimit ndërmjet fotografisë ideale dhe reale për vetveten dhe mundësisë për paraqitjen e çrregullimeve psikologjike të i mituri.

Etiketimi, gjuha e urrejtjes, përhapja masive e ndonjë qëndrimi nga ndonjë grup i caktuar, gjithashtu ka ndikim të madh në zhvillimin e personalitetit, e për fat të keq ky ndikim neglizhohet nga ana e të rriturve. Si mësimdhënës dhe prindër jo gjithmonë kushtojmë mjaftueshëm kujdes ndaj rreziqeve të fshehura pas titujve përkatës, personave që qëndrojnë pas profileve të caktuara, numrit të madh të profileve të rrejshme me të cilët fëmijët tonë janë në kontakt, e kështu me radhë.

Vërehet se sundon një qëndrim kolektiv me qasje jo mjaftueshëm serioze kah rrjetat sociale nga ana e të rriturve dhe ndikimi i tyre tek fëmijët e sjell në pyetje procesin edukativo arsimor ndaj fëmijës.

Si pedagogë dhe prindër jemi të detyruar të jemi në rrjedha me modernizimin e teknologjisë dhe zhvillimin e rrjetave sociale të cilat janë motor i shoqërisë bashkëkohore dhe vetëm në atë mënyrë, duke i kuptuar dhe ndjekur principet e këtyre rrjetave mundemi të ndikojmë në zhvillimin e fëmijëve tanë, e me këtë të krijojmë persona të cilët në mënyrë të suksesshme do t'i detektojnë dhe do t'u shmangen rreziqeve ndaj të cilave janë të ekspozuar.”

*Anita Armaginijan - Tasevska, pedagog shkollor në SHMQSH "Arseni Jovkov", thotë:*

„Shoqëria bashkëkohore në vete mbart ndryshime të cilat të gjithë ne i ndjejmë qoftë si prindër apo si mësimdhënës, madje i ndjejnë edhe fëmijët tanë. Këto ndryshime vërehen nga mosha 12 deri 15 vjeçare, kurse tek fëmijët shfaqet edhe nevoja që të jenë aktiv në rrjetat sociale

A jemi të gatshëm që si prindër, mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional t'u sqarojmë fëmijëve tanë dhe çka është më e rëndësishmja t'u kushtojmë kohë fëmijëve, të shohim çka postojnë ato në rrjetat sociale që janë indikatorë për ndryshimet që i përjetojnë? Rrjetat sociale na ofrojnë informata të ndryshme, fotografi, shpallje për diçka të re, interesante, por parashtrohet pyetja se sa e kanë e kuptuar krejt këtë dhe sa mund ta përdorin fëmijët dhe nxënësit e shkollave të mesme?

Mendimi i prindërve shpesh shkon nga njëra skajshmëri deri te tjetra, prej lejimit të fëmijëve të bëjnë gjithçka, deri te kufizimet dhe ndalimet. Nuk guxojmë të harrojmë se fëmijët në shkollë vijnë me

telefona të shtrenjtë dhe tableta, duke dashur të tregojnë statusin e tyre, por shpesh edhe i përdorin gjatë procesit mësimor, duke dashur t'i kenë të gjitha informatat dhe porosinë që përçohen nëpër rrjetat sociale.

Si prind, mësimdhënës dhe bashkëpunëtor profesional mendoj se fëmijëve duhet t'ua lëmë fëmijërinë ta jetojnë si fëmijë, të luajnë me lodra dhe me shokë, sepse atë periudhë të jetës nuk mund ta kthejmë asnjëherë më.

Mendimi im është se në këtë periudhë fëmija ose nxënësi i shkollës së mesme është i gatshëm të ndajë informata me moshatarët e tyre, por varet nga pjekuria dhe përgjegjësia e fëmijës nga njëra anë dhe kontrollit diskret të prindit nga ana tjetër. “

## Si mendojnë prindërit?

### **Cilat janë qëndrimet e prindërve në lidhje me publikimin e fotografive nga ana e fëmijëve në rrjetat sociale?**

*Suzana Avramovska, prind i nxënësit të shkollës së mesme “Pançe Karagjov” thotë: „Nuk jam kundër publikimit të fotografive nga fëmijët nëpër rrjetat sociale, nëse përmbajtja e atyre fotografive nuk është vulgare dhe nuk e cenon identitetin e fëmijës, në profilin i cili është i mbyllur për personat që nuk i kanë në listën e miqve... Në lidhje me pyetjen a duhet ata të kenë profil personal, mbi 15 vjet nuk jam kundër .. ndërsa nën 15 vjet duhet të jetë nën mbikëqyrjen e prindit. Më e rëndësishme është se nuk duhet fëmijëve t'u lejojmë ta zëvendësojnë jetën reale me atë virtuale.“*

*Prind i një nxënësi të shkollës së mesme „Josip Broz Tito” (anonim) mendon kështu: „Publikimi i fotografive nga ana e fëmijëve dhe bashkënxënësve të tij nuk e shoh si problem, përderisa nuk bëhet fjalë për përmbajtje të pahijshme ose materiale të cilat mund nga vetë publikimi të ofendojnë dikë ose të bëjnë thirrje në gjuhë të urrejtjes. Ajo që më shumë më frikëson si prind është që fëmija im mos të futet në situata të padëshiruara ose biseda të pahijshme. Mendoj se bisedimi më së shumti do të ndihmonte në atë rast, edhe pse nuk jam kundër që të hulumtojë vetë në internet për çështje të caktuara. Si do që të jetë, unë i largohem mundësisë të vendos fotografi të tij, pasi që lista e miqve të mi nuk është e njëjtë si lista e moshatarëve të tij. Me këtë, mendoj se e shkyçi mundësinë për keqpërdorime, por edhe nëse ai vetë nuk është i kujdesshëm, atëherë s'kemi bërë asgjë.“*

## Kapitulli 3

### Mekanizmat për paraqitje

DREJTORIA PËR MBROJTJE TË TË DHËNAVE PERSONALE – Procedura për parashtrim kërkese për kryerje të inspektimit – Qytetarët parashtrojnë kërkesa<sup>5</sup> dhe ankesa<sup>6</sup> deri te Drejtoria që kanë të bëjnë me keqpërdorimet në rrjetat sociale, drejtoria vepron sipas kërkesave dhe ankesave të cilat kanë të bëjnë me llojet më të shpeshta të keqpërdorimeve në rrjetat sociale siç janë fshirja e profileve të rrejshme në Facebook, fshirja e profileve të hakura (vjedhura). Drejtoria vepron edhe sipas ankesave për zbulimin e IP adresave të cilat i ridërgon deri te Ministria e punëve të brendshme, publikimin e paautorizuar të fotografive, ankesat për keqpërdorim të të dhënave personale të të miturve, etj. çdo vit ritet numri i kërkesave dhe ankesave të cilat qytetarët i parashtrojnë deri te Drejtoria<sup>7</sup>.

Nëse ju ballafaqoheni me keqpërdorim të të dhënave tuaja personale ose të dhënave personale të fëmijës tuaj ose vetëm dyshoni në keqpërdorim, mund të paraqiteni në Drejtorinë për mbrojtje të të dhënave personale në [info@privacy.mk](mailto:info@privacy.mk) ose në tel.: 02/3230-635

Ankesa përpunohet menjëherë, shqyrtohet dhe dorëzohet seri te personi përgjegjës për këtë. Nëse ankesa ka të bëjë. Nëse ankesa ka të bëjë me keqpërdorim të të dhënave personale në rrjetat sociale dhe pala kërkon fshirjen e profilit të rrejshëm ose profilit të thyer/vjedhur, Drejtoria pas pranimit (dorëzimit të dokumentacionit të kompletuar) me ndihmën e personave të autorizuar, komunikon me ekipin administrues për ndihmë profesionale të rrjetit social dhe kërkon fshirjen. Pas përgjigjes së marrë menjëherë informohet ankuesi.

Nëse Drejtoria nuk është kompetente për çështjen e parashtruar, ankesa dërgohet deri institucioni kompetent dhe për këtë gjithashtu njoftohet parashtruesi i kërkesës. Nëse ankesa është dorëzuar në me tepër organe njëkohësisht, organet bashkëpunojnë ndërmjet veti.

Nëse ankesa është e paqartë ose nuk mund të veprojë sipas asaj, nevojitet që parashtruesi ta precizojë ose të sjellë dëshmi. Gjithashtu, mund të kërkohet që parashtruesi të thirret në Drejtorinë për të vërtetuar gjendjen faktike. Në secilin rast Drejtoria i bën të ditura masat e marra në lidhje me ankesën.

Nëse eventualisht pas ankesës hapet dyshimi se duhet të kontaktohen sektorë tjerë të drejtorisë (p.sh. inspektim) ose institucione tjera jashtë saj (p.sh. Prokurori publik, MPB, etj.) personat përgjegjës për shqyrtimin e ankesave duhet të dorëzojnë iniciativë/kërkesë/informacion deri te nëpunësi përkatës në Drejtori.

---

<sup>5</sup> <http://www.dzlp.mk/mk/prizInlp>

<sup>6</sup> Nën ankim, respektivisht propozim, në Ligjin për veprim sipas ankimeve dhe propozimeve, nënkuptohet çdo adresim me shkrim ose gojor të parashtruesve deri te organet të cilat veprojnë sipas ankimeve, respektivisht propozimeve për shkak të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të tij, interesave publike të rregulluara me ligj ose për shkak të fillimit të një iniciative tjetër me interes publik.

<sup>7</sup> Shihni Raportin vjetor të DMDHP për 2013 dhe 2014

[http://www.dzlp.mk/sites/default/files/u4/Godisen\\_izvestaj\\_DZLP\\_2013.pdf](http://www.dzlp.mk/sites/default/files/u4/Godisen_izvestaj_DZLP_2013.pdf)

<http://dzlp.mk/sites/default/files/u1002/MK.pdf>

OFICER PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË Nëse ballafaqoheni me keqpërdorim të të dhënave personale të fëmijës tuaj në shkollë, mund ta informoni edhe Oficerin për mbrojtje të të dhënave personale në shkollën ku mëson fëmija juaj. Në realitet, secila shkollë ka obligim ligjor, në pajtim me nenin 26 nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, secili kontrollues është i detyruar të caktojë Oficer për mbrojtjen e të dhënave personale i cili do t'i kryejë këto punë: të merr pjesë në sjelljen e vendimeve lidhur me përpunimin e të dhënave personale, si dhe me realizimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, e ndjek pajtueshmërinë me ligjin dhe me rregullat të sjella në bazë të ligjit, etj. që do të thotë se ka obligim të jetë i njoftuar dhe të reagojë nëse është nevoja në ca procedura apo rregulla të shkollës nëse nuk sigurojnë fshehtësi dhe mbrojtje të të dhënave personale të nxënësve që mësojnë në atë shkollë. Oficeri është njëherit edhe vegël e cila është e rëndësishme në procesin e informimit për mbrojtjen e të dhënave personale jo vetëm të nxënësve por edhe të mësimitdhënësve/të punësuarve në shkollë.

## Kapitulli 4

### Softuerë të dobishëm për mbrojtje të privatësisë së fëmijëve tuaj

Softueri për kontroll prindëror është mënyrë e shkëlqyer për kontrollim, kufizim dhe mbikëqyrje të aktiviteteve të fëmijëve derisa ata janë në internet. Por, siguria e tyre nuk është gjëja e vetme që mund të rrezikohet si rezultati përdorimit joadekuat të internetit. Siguria e gjithë familjes, por edhe kompjuterit të cilin e përdorin të gjithë gjithashtu mund të jenë të rrezikuara. Prandaj, duhet të bisedoni me fëmijët tuaj dhe t'u jepni këshilla të dobishme, si dhe të mësoni si të kujdeseni për kompjuterin tuaj që të siguroni funksionimin e tij të rregullt. Disa softuerë shfrytëzues që mund t'ju ndihmojnë që të përkujdeseni për sigurinë e fëmijës tuaj derisa ai shfrytëzon internetin janë:

- **Crawler Parental Control** është një nga softuerët e rrallë falas, gjithëpërfshirës dhe tërësisht funksional për kontroll prindëror. Menjëherë pas instalimit jepet një fjalëkalim administratori e cila prindit i mundëson t'i bëjë konfigurimet për secilin përdorues të kompjuterit veçmas. Softueri mundëson kontrollim të kohës që shfrytëzuesi e kalon në internet, si dhe limitimi i kohës të cilën përdoruesi mund ta kalojë në kompjuter. Mund të përmenden disa ueb sajte të cilat shfrytëzuesi mund ti vizitojë, që do të jenë të lejueshme për të, si dhe fjalë të cilat nëse hasen në ndonjë ueb faqe, do të ndalojë qasjen në atë faqe

Crawler Parental Control mundëson edhe kufizim të qasjes së shfrytëzuesve deri te disa dosje ose deri tek disku i tërë në kompjuter. Ky kufizim mund të jetë i tërësishtëm ose të vlejë për periudha të caktuara të javës dhe ditës, e gjithashtu ekziston edhe opsioni për të lejuar disa orë të caktuara që shfrytëzuesit mund t'i kalojnë brenda një muaji, jave ose dite. Gjithsesi mund të bllokohen edhe programe të caktuara, si dhe ndalime deri te qasja e lokacioneve sistemore për arsye të parandalimit të ndryshimeve që mund ta paaftësojnë punën e rregullt të sistemit.

Për gjithë këtë, ju si prind, nëse dëshironi mund të ju vijë raporte.

Linku për shkarkim: [http://download.cnet.com/Crawler-Parental-Control/3000-27064\\_4-10549693.html](http://download.cnet.com/Crawler-Parental-Control/3000-27064_4-10549693.html)

- **Glubble** është një vegël e popullarizuar familjare, e cila përdoret si vegël shtuese në ueb shfletuesin Mozilla Firefox. Edhe pse përdorimi i tij është kufizuar vetëm për këtë shfletues, mund të përdoret në të gjitha sistemet operative. Me ndihmën e kësaj vegle shtojcë, shfletuesi ndahet në dy pjesë, me ç'rast njërin e përdorin dhe e administrojnë prindërit, ndërsa tjetrin fëmijët. Për çdo fëmijë mund të përpilohet profil i veçantë, i cili do të mundësojë aktivitete në internet të përshtatshme për moshën e tij.

Në fillim prindi zgjedh një fjalëkalim administratori, me ndihmën e së cilës ai do të mund t'i bëjë konfigurimet e dëshiruara, si dhe ta përdore shfletuesin për nevojat e tij. Në momentin kur ndonjëri prej fëmijëve do të dëshirojë të përdorë shfletuesin, ai thjeshtë duhet të zgjedhë profilin e tij, dhe në këtë rast ai do të ketë një mjedis pune krejtësisht të ri nga i cili do të mund të surbojë nëpër listën e



definuar me ueb sajte edukative dhe zbavitëse, të kërkojë të vizitojë faqe të reja , sidomos ato interesantet dhe vetëm me një klik ti vendosë ato në koleksionin e të preferuarave, ose të lë porosi për anëtarët tjerë të familjes. Mundësitë për kërkim janë të kufizuar në nocione(shprehje) të sigurta. Deri tani përmbajtjet të cilat janë pjesë e Glubble janë në gjuhën angleze, por ju thjeshtë mund t'i shtoni edhe ato në gjuhën shqipe.

Linku për shkarkim : <https://addons.mozilla.org/EN-us/firefox/addon/glubble-fox-family>

- **K9 Web Protection** është një vegël falas për filtrimin e ueb përmbajtjeve dhe vendosjes së kontrollit prindëror ndaj aktiviteteve të fëmijëve derisa janë në internet. Për përdorim të tij është e nevojshme licenca, të cilën mundeni falas ta merrni nëpërmjet emailit nëse e kaloni procedurën për regjistrim

Çka mund të rregulloni me K9 Web Protection?

Me këtë softuer, para së gjithash mund ta caktoni nivelin e mbrojtjes për profilin shfrytëzues të dëshiruar, qasjen deri tek i cili do ta ndaloni me vendosjen e fjalëkalimit. Mund të zgjidhni ndërmjet disa niveleve të ofruara të mbrojtjes, të cilët përfshijnë ndalim të vizitimit të një lloji të caktuar të përmbajtjeve ose listën me përmbajtje të ndaluara ta përpiloni vetë. Më tej, mund të zgjidhni periodha gjatë ditës në të cilat do ta ndaloni përdorimin e shfrytëzimit të browserit, si dhe periodha kur do të jetë i lejuar përdorimi.

Disa ueb sajte të caktuara mund të jenë të ndaluara për qasje, derisa disa mund të jenë gjithmonë të lejuara. Ndalea mund të vendoset edhe në bazë të fjalëve të dhëna kyçe, si dhe të zgjidhet mënyrë për lajmërim ose ndëshkim nëse tentohet të qaset deri te përmbajtjet e ndaluara.

Mi siguri, njëra nga punët më të rëndësishme që i mundëson ky softuer është sistemi i detajuar për lajmërim, nga i cili mund të merrni një pasqyrë të qartë të aktiviteteve që i bën në internet fëmija juaj.

Linku për shkarkim: <http://www1.k9webprotection.com>

- **WebFilter Pro** është shtojcë për ueb shfletues i cili mundëson mënyrë të thjeshtë për bllokim të përmbajtjes për të rritur, proksi serverë dhe ueb sajte të ndryshme për rrjetëzim social pa vendosjen e kufizimeve kohore ose sanksioneve tjera të padëshiruara. Shfrytëzuesit mund të bllokojnë gjithçka nga lakuriqësia, bastoret dhe lojërat. Kjo shtojcë mundëson konfigurim të listave individuale të bardha dhe të zeza duke mundësuar qasje deri te një numër i caktuar i ueb sajteve që nuk bëjnë pjesë në ndonjërin nga shumë kategoritë për filtrim të kësaj shtojce.

Linku për shkarkim: <https://addons.mozilla.org/en-US/firefox/addon/webfilter/> и  
<https://chrome.google.com/webstore/detail/webfilter-pro-the-best-fi/ejgfolefbjadjcgimnhfbdfjolojnn?hl=en>

- **FoxFilter** është shtojcë e dizajnuar me qëllim që t'u mundësoje shfrytëzuesve filtra për bllokim në bazë të fjalëve kyçe individuale dhe ueb sajteve (p.sh. playboy, lakuriqësi, fyerje, të shara), duke dhënë mundësi për shtimin e ueb sajteve të besueshme në listën e moderuar të përmbajtjeve.

Parametrat e rregullimit të kësaj shtojce mundësojnë skenim si të përmbajtjes së ueb sajtit ashtu edhe emrin e URL-së, ndërsa shfrytëzuesit mund vetë të rregullojnë njoftimet dhe paralajmërimet për llojin e përmbajtjes në bazë të secilit sajt të bllokuar.

Linku për shkarkim: <https://addons.mozilla.org/en-us/firefox/addon/foxfilter/> и <https://chrome.google.com/webstore/detail/foxfilter-the-content-fil/nopeodilmhhlfageehojginlgeljk>

- **Nanny za Google Chrome, LeechBlock za Firefox** – Ashtu siç rriten fëmijët, duket se disa brenga nuk kalojnë. Por, menaxhimi i kohës bëhet një burim i madh i brengës, veçanërisht për tinejxherët jetët e të cilëve fillojnë të sillen rreth ndërveprimeve sociale, respektivisht sajteve për rrjetëzim social. Këto ekstensione bllokojnë ueb sajte konkrete në kohë të caktuar të ditës me qëllim që të pamundësohet tërheqja e vëmendjes dhe të përmirësohet produktiviteti. Për shembull, mund ta bllokoni Facebookun nga mesdita deri në orën 6 pasdite.

Këto dy ekstensione (shtojca) gjithashtu ju mundësojnë të caktoni sa kohë mund fëmijët tuaj të kalojnë duke vizituar sajte të caktuara, do të thotë se mund të bllokoni ueb sajtin për disa orë e jo tërësisht.

Linku për shkarkim: <https://chrome.google.com/webstore/detail/web-nanny/pbdfecacmbjblfbnkgknimpdgiqhpha?hl=en> dhe <https://addons.mozilla.org/en-us/firefox/addon/leechblock/>

- **TinyFilter** është ekstension për Google Chrome i cili është shumë i thjeshtë dhe bllokon qasjen deri te disa ueb përmbajtje në bazë të një përmbledhjeje të fjalëve kyçe të cilat ndalojnë qasjen deri te të gjitha ueb sajtet që i përmbajnë këto fjalë nga lista e zezë. Ky ekstension mund të bllokojë ueb sajte në bazë të një URL të dëshiruar, por roli primar është filtrimi i përmbajtjes sipas fjalës së dhënë kyçe

Linku për shkarkim: <https://chrome.google.com/webstore/detail/tinyfilter-reliable-conte/nlfgnnlnfbpcammlnibfkplpnbbbdeli?hl=en>

- **Golden Eye** është softuer i fuqishëm për spiunim dhe mbikëqyrje të të gjitha aktiviteteve në kompjuter: futja e fjalëkalimeve dhe të dhënave tjera, ueb faqe të vizituara, aplikacione të përdorura dhe e gjithë kjo me fotografi të kapura në momentin e përdorimit. Ky softuer kushton \$29,95.

Linku për shkarkim: <http://www.monitoring-spy-software.com>

- **Safe Eyes** i përmbledh të gjitha opsionet e nevojshme për kontroll prindëror: kufizon qasjen deri te disa ueb sajte të caktuara dhe programe, e kufizon kohën për aktivitete të ndryshme në internet, ruan vërejtjet për aktivitetet dhe paralajmëron për kundërvajtjet në disa mënyra. Licenca për këtë softuer kushton \$49,95.

Linku për shkarkim: <http://www.internetsafety.com>

- **Web Watcher** është njëri nga softuerët më të mirë për filtrim, bllokim të programeve, kufizim kohor dhe mbikëqyrje të avancuar të aktiviteteve të fëmijës derisa ai përdor kompjuterin. Licenca për të kushton \$97.00 për një vit.

Linku për shkarkim: <http://www.webwatchernow.com>

- **Cyber Patrol** është program për kontroll prindëror me një zgjedhje të begatshme të opsioneve për filtrim, bllokim të programeve, menaxhim të kohës së lejuar dhe mbikëqyrje, e dedikuar për përdorues më të avancuar. Këtë program mund ta testoni falas 14 ditë, e kushton \$39.95 për një vit.

Linku për shkarkim: <http://www.cyberpatrol.com>

- **Net Nanny** është softuer për kontroll prindëror me karakteristika filtruese, mundësi për bllokim të programeve për biseda dhe programeve për ndarjen e fajllave, grupe (newsgroups) dhe mundësi të dobëta për mbikëqyrje të aktiviteteve. Mund ta testoni falas 15 ditë, ndërsa kushton \$39.99 për një vit.

Linku për shkarkim: <http://www.netnanny.com>

- **Parental control bar** mundëson filtrimin e ueb përmbajtjeve të padëshiruara dhe ofron një kalim të thjeshtë nga regjimi prindëror i mbrojtur me fjalëkalim në regjimin për fëmijë.

Linku për shkarkim: <http://www.parentalcontrolbar.org>

- **KidZui** është shfletues për fëmijë nga mosha 3 deri 12 vjeçare. Fëmijëve u mundësohet përjetim i përvojave multimediale në internet, ndërsa prindërve u mundëson kontrollin prindëror.

Linku për shkarkim: <http://www.kidzui.com>

## Këshilla për mbrojtje të privatësisë së fëmijëve tuaj

**Vendosni disa rregulla elementare-** Fëmijët duhet ta dinë se nën cilat kushte, në cilën periudhë dhe në çfarë mënyre mund ta përdorin internetin. Këto kushte i caktoni ju. Filloni, p.sh. me atë se mund të hyjnë në internet vetëm nëse i mbarojnë obligimet shkollore.

**Kompjuteri në vend qendror** – Vendosni kompjuterin në vend qendror në dhomë ose në klasë që të mund të shihni kohë pas kohe se çka bëjnë fëmijët tuaj. Kjo është me rëndësi sepse mund të ndiqni nëse fëmija juaj rastësisht has në përmbajtje të cilat nuk janë të përshtatshme për moshën dhe interesat e tij.

**Vendosni kufizim kohor** – Rekomandohet që fëmijët mos të kalojnë më tepër se 1 deri 2 orë para monitorit të kompjuterit në ditë. Për fëmijët deri në moshën 7 vjeçare, më mirë është që përmbajtjet t'i shfletoni bashkë me to, ndërsa për fëmijët më të mëdhenj është me rëndësi të caktoni se ku mund të hyjnë e ku jo, para se të fillojnë aktivitetin e tyre në internet

### Mësoni fëmijët që të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt në internet

- U tregoni fëmijëve tuaj se nuk mund t'i japin të dhënat e tyre personale njerëzve të panjohur në internet dhe ua kujtoni se duhet t'i përdorin parametrat për privatësi në faqet e tyre personale për rrjetëzime sociale. Informacionet që i lënë për vete, duhet të jenë private, respektivisht të kufizuara për t'ju qasur. Mjafton që këto lloje informatash të mund t'i shohin vetëm shokët dhe familja. Ata nuk do të kishin dashur që t'i bëjnë publike të dhënat të cilat një ditë do të ishin pengesë për në fakultet te i cili do të donin të studionin ose për punën që do të kishin dëshirë ta punonin. Ua kujtoni se nuk është etike të zbulojnë të dhëna personale për shokët ose familjet e tyre. Kur publikojnë fotografi duhet t'i bëjnë private dhe të mos i tagojnë (etiketa me të cilat përshkruhen të pranishmit në fotografi).
- Fëmijët duhet të mbajnë mend se fjalëkalimet janë vetëm për to dhe të kenë kujdes asnjëherë mos e kyçin opsionin për memorim automatik të emrit të shfrytëzuesit dhe fjalëkalimit kur kontrollojnë emailin e tyre ose kur përdorin programe për biseda nga ndonjë kompjuter publik.
- Mësoni fëmijët që mos dalin të takojnë me të vërtetë njerëzit që i kanë takuar në internet. Nëse ju pajtoheni që fëmija juaj të takohet me ndonjë që e ka njoftuar në internet, më mirë është që edhe ju të shkoni me të dhe takimi të bëhet në ndonjë vend publik. Tinejxherët të cilët nuk do të duan të shkojnë me një të rritur, le të marrin së paku një shokë me vete.
- Për fëmijët është më lehtë të sillen pahijshëm në internet se sa me të vërtetë. Kësaj i kontribuon mundësia për përdorim të nofkave të cilat fshehin fajtorët e vërtetë për ndonjë porosi të keqe, ndërsa porositë e tilla mund lehtë dhe shpejt të përhapen deri te të gjithë fëmijët e shkollës. Kjo dukuri njihet me emrin sjaberdhuna (cyberbullying).
- Një rregull të cilës fëmijët duhet t'i përmbahen është: nëse dikujt nuk mundesh t'ia thuash në fytyrë, mos ia thuaj as nëpërmjet emailit, SMS, çetit ose instant porosive dhe as mos e postojë në faqen e dikujt.
- Që ata të mbrojnë veten nga email porositë e padëshiruara, fyese ose kërcënuese, ua tregoni mundësinë e shfrytëzimit të opsionit për filtrimit të emailave të padëshiruar nëpërmjet servilit që ua ka mundësuar email adresën. Më tepër informata për bllokim të email porosive nga

persona të padëshiruar do të gjeni këtu: <http://www.bezbednonainternet.org.mk/blokiranje> ose [http://bezbednonainternet.org.mk/component/option,com\\_docman/task,doc\\_download/gid,66/Itemid,38/lang,mk/](http://bezbednonainternet.org.mk/component/option,com_docman/task,doc_download/gid,66/Itemid,38/lang,mk/)

- Mësoni fëmijët që t'i publikojnë përmbajtjet me përgjegjësi. Ata duhet t'i shohin kushtet e përdorimit të serviseve para se të vendosin publikojnë diçka me ndihmën e tyre. Gjithashu, nëse ata vërejnë ndonjë përmbajtje të papërshtatshme, kuptohet nëse ekziston opsioni, mund t'a shënojnë si të tillë që të parandalojnë që edhe fëmijë të tjerë të mos hasin në to. Kështu lloj opsioni ka p.sh. servisi You-Tube, i cili mundëson vendosjen e flamujve tek videot e papërshtatshme, pas së cilës ata mund të fshihen.
- Ua rikujtoni fëmijëve se gjithçka që publikohet në internet nuk është patjetër e saktë. Në përmbajtjet duhet të shikohet në mënyrë kritike, informacionet duhet të kontrollohen në më shumë burime, si dhe të kontrollohet autori i tekstit të cilin mendojnë ta marrin si bazë për projektin e tyre shkollor ose për ndonjë aktivitet të tyre personal. Mësoni ata si të dallojnë një përmbajtje autentike nga ajo që nuk është dhe ua kujtoni se kopjimi i teksteve nga ndonjë ueb sajt mund të paraqesë plagjiat.
- Në pajtim me rregullat e bontonit, mund të jetë ide e mirë që të kontrolloni historikun e kompjuterit dhe telefonit të fëmijëve tuaj si dhe të kërkoni që t'ua tregojnë të gjitha fjalëkalimet për të gjitha profilet ... Por kini ndërmend se thyerja e rregullave të privatësisë mund vetëm ta largojë fëmijën Tuaj nga Ju..
- Besoni fëmijës tuaj mjaftueshëm dhe mos e rënoni privatësinë e tij/saj pa arsye.
- Vendosni limite, rregulla dhe drejtime të sjelljes që janë të lejuara në mediumet sociale, si dhe caktoni kohën sa mund të kalojnë ata në mediumet sociale. Psikologët paralajmërojnë se tinejxherët me smartfonët e tyre kanë tendencë të jenë më të interesuar për sajber botën dhe të pavetëdijshëm për botën rreth tyre, por ju si prind mund ta parandaloni këtë duke vendosur rregulla.
- Rregullisht informohuni për kërcënimet e mundshme në internet. Rreziqet që sjell interneti janë shumë më tepër se vetëm internet predatorë ose vjedhje identiteti. Respektivisht, tinejxherët nuk janë të vetmit shfrytëzues të lëndueshëm.
- Bile edhe prindërit mund të bëjnë gabime në mediumet sociale!!! Asnjëherë mos e paralajmëroni pushimin dhe pritni derisa të ktheheni në shtëpi e pastaj postoni fotografi të plazhit më të bukur të kësaj vere!.
- SA MË SHUMË TË JENI TË KYÇUR NË ONLAJN BOTËN, AQ MË TEPËR DO TË DINI PËR FËMIJËN TUAJ DHE SI TË BISEDONI ME TË. POROSIA KRYESORE ËSHTË: QËNDRONI TË KYÇUR!

## Resurse të dobishme

- [www.privacy.mk](http://www.privacy.mk)
- [www.metamorphosis.org.mk](http://www.metamorphosis.org.mk)
- [www.bezbednonainternetorg.mk](http://www.bezbednonainternetorg.mk)
- [www.nemrazi.mk](http://www.nemrazi.mk)

# Shtojca

## Shtojca 1 – [Akronimet që më shpesh përdoren nga tinejxherët](#)

1. **143** I love you
2. **2DAY** Today
3. **4EAE** For ever and ever
4. **ADN** Any day now
5. **AFAIK** As far as I know
6. **AFK** Away from keyboard
7. **ATM** At the moment
8. **B/C** Because
9. **B4** Before
10. **BF / GF** Boyfriend / Girlfriend
11. **BFN** Bye for now
12. **BOL** Be on later
13. **BRB** Be right back
14. **BTW** By the way
15. **DM** [Direct message](#)
16. **DWBH** Don't worry, be happy
17. **F2F or FTF** Face to face
18. **FB** Facebook
19. **FF** [Follow Friday](#)
20. **FTL** For the loss / For the lose
21. **FTW** For the win
22. **FWB** Friends with benefits
23. **FWIW** For what it's worth
24. **FYEO** For your eyes only
25. **FYI** For your information
26. **GLHF** Good luck, have fun
27. **GR8** Great
28. **HAK** Hugs and kisses
29. **HAND** Have a nice day

30. **HT or H/T** Hat tip or heard through
31. **HTH** Hope this helps / Happy to help
32. **IANAL** I am not a lawyer
33. **IDK** I don't know
34. **IIRC** If I remember correctly
35. **IKR** I know, right?
36. **ILY / ILU** I love you
37. **IMHO** In my honest opinion / In my humble opinion
38. **IMO** In my opinion
39. **IRL** In real life
40. **IU2U** It's up to you
41. **IYKWIM** If you know what I mean
42. **J/K** Just kidding
43. **J4F** Just for fun
44. **JIC** Just in case
45. **JSYK** Just so you know
46. **K or KK** Okay
47. **LMBO** Laughing my butt off
48. **LMK** Let me know
49. **LOL** Laughing out loud
50. **MM** [Music Monday](#)
51. **MSM** Mainstream media
52. **NAGI** Not a good idea
53. **NM** Never mind
54. **NMU** Not much, you?
55. **NP** No problem or Now playing
56. **NSFW** Not safe for work
57. **NSFL** Not safe for life
58. **NTS** Note to self
59. **OH** Overheard
60. **OMG** Oh my God
61. **ORLY** Oh, really?



62. **PAW** Parents are watching
63. **PLS or PLZ** Please
64. **PPL** People
65. **PTB** Please text back
66. **QQ** Crying.
67. **RAK** Random act of kindness
68. **RL** Real life
69. **ROFL** Rolling on the floor laughing
70. **RT** [Retweet](#)
71. **RUOK** Are you okay?
72. **SMH** Shaking my head
73. **SRSLY** Seriously
74. **SSDD** Same stuff, different day
75. **SWAK** Sealed with a kiss
76. **SWYP** So, what's your problem?
77. **TIA** Thanks in advance
78. **TIME** Tears in my eyes
79. **TMB** Tweet me back
80. **TMI** Too much information
81. **TMRW** Tomorrow
82. **TTYL** Talk to you later
83. **TY or TU** Thank you
84. **VSF** Very sad face
85. **WB** Welcome back
86. **WTH** What the heck?
87. **WTPA** Where the party at?
88. **WYCM** Will you call me?
89. **YGM** You've got mail
90. **YMMV** Your mileage may vary
91. **YW** You're welcome
92. **OMG** Oh my god

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

004.738.5:342.738-053.5(036)

UDHËZUES për prindër për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijëve në internet [Електронски извор] / [përpiluan Liljana Pecova Ilieska, Tamara Resavska]. - Текст во PDF формат, содржи 34 стр.. - Shkup : Metamorfozis : Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, 2015

Начин на пристап (URL): <https://metamorphosis.org.mk>

Начин на пристап (URL): <https://privacy.mk>. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 22.12.2015

ISBN 978-608-4564-58-4 (Метаморфозис)

ISBN 978-608-4682-24-0 (Дир. за заштита на лич.податоци)

а) Интернет - Заштита на лични податоци - Водичи  
COBISS.MK-ID 100209930